

VENDIM
Nr. 556, datë 31.7.2019

**PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT, NGA KËSHILLI
I MINISTRAVE TE MINISTRIA E FINANCIVE DHE EKONOMISË, TË
PASURISË ME EMËRTIMIN “GODINË RESTORANT DY KATE, STABILIMENT
DURRËS”, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 1058, DATË 16.7.2008,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË
INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I
KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI KËSHILLIT TË MINISTRAVE,
PËR DREJTORINË E SHËRBIMEVE QEVERTARE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, shkronja “c”, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Këshilli i Ministrave te Ministria e Financave dhe Ekonomisë, të pasurisë “Godinë restorant dy kate, stabiliment Durrës”, në përdorim të Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare, sipas listës së inventarit që i bashkëlidhet vendimit nr. 1058, datë 16.7.2008, të Këshillit të Ministrave.

2. Pasuria e përmendur në pikën 1, të këtij vendimi, hiqet nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme, që i bashkëlidhet vendimit nr. 1058, datë 16.7.2008, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Këshillit të Ministrave, për Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare”.

3. Ngarkohen Kryeministria, Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama